


Të shtëna me armë zjarri në Prishtinë, plagoset një person



06/11/2024 08:58



Të shtëna me armë zjarri pati mëngjesin e sotëm në lagjen “Kodra e Trimave” në Prishtinë.

Si shkak i këtyre të shtënave një person është plagosur.



Kjo është konfirmuar për lajmi.net nga zëdhënësja e policisë për rajonin e Prishtinës, Flora Ahmeti.

“Sot rreth orës 07:00 policia ka marrë informatën për një plagosje me armë zjarri të ndodhur në lagjen “Kodra e Trimave” në Prishtinë. Menjëherë pas marrjes së informatës policia ka dalë në vendin e ngjarjes dhe ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që konsistojnë në hetimin e rrethanave që e karakterizojnë ngjarjen. Dyshohet se nga një person është plagosur me armë zjarri dhe i njëjti është dërguar për tretman mjekësor”, tha ajo.

Ahmeti theksoi se aktualisht hetuesit policor në koordinim me prokurorinë po ndërmarrin veprimet hetimore për ndriçimin e plotë të rastit./Lajmi.net/

Më shumë nga uebi

nativeGRAM
by LajmiMedia




Artikuj të ngjashëm



November 6, 2024

Grenell: Amerika dhe bota ka shpëtuar



November 6, 2024

Trump flet për Elon Musk, e quan “super-gjeni”



November 6, 2024

Kryeministri Rama uron Trumpin për fitoren: Urimë për Donald Trumpin në...



November 6, 2024

Ia huq Dimal Basha, dje tha se Kamala Harris do të fitoj bindshëm



November 6, 2024

Kryeministri izraelit uron Trump-in: Kthimi më i madh në histori



November 6, 2024

Vuçić dhe Dodik urojnë Trumpin për fitoren e pretenduar në SHBA